3. Në rastet e parapa në paragrafin dy të këti neni dhe ligjin mbi arsimin e lart në nenin 14 pika 5.8. ku decidivisht kërkohet që bartësit e lartë të kenë marrëveshje me të paktën dy Kolegje, palët nënshkruese të kësaj marrëveshje marrin për obligim dhe zotohen që për programin e specifikuara ne tabelë do ta realizojnë transferimin sipas dispozitave te kesa marrëveshje dhe ligjit mbi arsimin e lartë.

Kolegji "UNIVERSUM"	Kolegji "VICTORY"
Administratë Publike, Marrëdhënie ndërkombëtare (BA)	Politikë Ndërkombëtare, Diplomaci (BA)
E Drejta dhe Menaxhmenti (BA)	Juridik (BA)

II. Fushëveprimtaria

Bashkëpunimi i ndërsjellët i palëve do të realizohet në këto fusha:

1. Shkëmbimi i përvojave akademike të Kolegjit "UNIVERSUM" dhe Kolegjit "VICTORY", me qëllim arritjen e standardeve bashkëkohore në fushat të ndryshme Universitare;
2. Shkëmbimi i studentëve të Kolegjit "UNIVERSUM" dhe Kolegjit "VICTORY";
3. Bartja e studentëve në rastet se ndaj palëve nënshkruese Agjencioni i Akreditimit të Kosovës fillon procedurat e heqjes së akreditimit apo rastet e tjera të parapara në pikën dy (2), neni (I) të kësaj marrëveshje dhe ligjin mbi arsimin e lartë publik;
4. Organizimi i përbashkët i aktiviteteve në fusha të ndryshme shkencore, ekonomike, politike dhe kulturore nëpërmjet simpoziumeve, konferencave, debateve;
5. Qasje në projekte të ndërsjella, nëpërmjet të cilave do t'u mundësohet pedagogëve, studentëve dhe stafit udhëheqës dhe menaxhues, të kenë mundësi të përfshihen në projekte të përbashkëta që do të ndërmerren nga Kolegji "UNIVERSUM" dhe Kolegji "VICTORY";
6. Konkurrimi në projekte të përbashkëta vendore, ndërkombëtare, nëse mes palëve ekziston vullneti dhe dëshira.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas kësaj marrëveshje, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë marrëveshje apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër.
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë.

IV. Dispozitat e Fundit

1. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe brenda kuadrit të etikës morale;
2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit;
3. Kjo marrëveshje është përpiluar në katër kopje identike, dhe secila palë merë nga dy kopje.

Prishtinë, më 19.06.2012

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji "UNIVERSUM"

Kryetari i Bordit, te cilin me autorizim e përfaqëson Visar Kastrati

z. Suat BERISHA

Kolegji "Victory"

Rektori, te cilin me autorizim e përfaqëson Vjollca Salihu

z. Bedri Selmani

Akt en brevet nr.ref.0051/12

Sot, më datë NËNTËMBËDHJETË QERSHOR DY MIJË E DYMBËDHJETË, ditën e Martë, para meje, Arbena Shehu, Notere ME SELI NË PRISHTINË, Rruga Garibaldi numër 7/1, vërteton se: ----------

Nënshkrimin e Z.Visar Kastrati i cili me autorizim e perfaqeson Z.Suat Berisha Kryetari i Bordit të Kolegjit Universum i njejti ka nenshkruar Marrëveshje për transferim të studentëve dhe njohje të ndërsjellët midis Kolegjit Universum dhe Kolegjit Victory-Prishtinë , vërtetoj se ky nënshkrim është vënë nga Z.Visar Kastráti i lindur në Prishtinë me tre shkurt njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë, nga i ati Lulzim, me profesion Jurist, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, Rr."Rexhep Mala", nr.17, identiteti i të cilit konstatohet nga letërnjoftimi me numër personal 2173213037 i lëshuar nga MPB më datë 14.04.2009, i cili gëzon ushtrimin e të drejtave të tija të veprimit.(Autorizimi i Z.Visar kastrati ipet/vlen vetem per nenshkrimin e marreveshjeve ndermjet Universiteteve eshte i vulosur me vuke te Kolegjit Universum dhe e nenshkruar))----------

Veprimi i noterizimit u krye në Prishtinë, në selinë e Noteres Arbena Shehu në adresën e lartëshënuar me datën nëntëmbëdhjetë qershor dy mijë e dymbëdhjetë. ----------

NOTERJA

Arbena Shehu

Akt en brevet nr.ref.0051/12

Sot, më datë NËNTËMBËDHJETË QERSHOR DY MIJË E DYMBËDHJETË, ditën e Martë, para meje, Arbena Shehu, Notere ME SELI NË PRISHTINË, Rruga Garibaldi numër 7/1, vërteton se: ----------

Nënshkrimin e Vjollca Salihu e cila me autorizim e perfaqeson Rektorin e Kolegjit Victory Z.Bedri Selmani i e njejta ka nenshkruar Marrëveshje për transferim të studentëve dhe njohje të ndërsjellët midis Kolegjit Universum dhe Kolegjit Victory-Prishtinë, vërtetoj se ky nënshkrim është vënë nga Vjollca Salihu e lindur në Prishtine me njëzet e gjashtë një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre, nga i ati Xhemajl, me profesion juriste, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, Rr."Ulpiana D1, hyrja 10 nr.10, identiteti i të cilit konstatohet nga letërnjoftimi me numër personal 1011359619 i lëshuar nga MPB më datë 02.02.2010, i cili gëzon ushtrimin e të drejtave të tija të veprimit.----------

Veprimi i noterizimit u krye në Prishtinë, në selinë e Noteres Arbena Shehu në adresën e lartëshënuar me datën tetëmbëbëdhjetë qershor dy mijë e dymbëdhjetë. ----------

NOTERJA

Arbena Shehu

Protokoll i Bashkëpunimit

Shoqata e Miqësisë Franko-Shqiptare
Kolegji Universum

1. Të udhëhequr nga parimet e mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë, nga nevoja për zhvillim dhe thellim të bashkëpunimit akademik.
2. Për të bashkëpunuar në fushën akademike duke krijuar kontakte të drejtpërdrejta edhe për anëtarët e departamenteve dhe fakulteteve.
3. Për të kryer aktivitetet që nevojiten për të realizuar objektivat e marrëveshjes. Për ngritjen e vlerave akademike, arsimore dhe shkencore.
4. Jemi të bindur se kjo marrëveshje e bashkëpunimit, është me interes dhe në dobi të studimeve të kërkimore në universitare dhe zhvillimin e projekteve dhe programet arsimore-shkencore.
5. Organizmin e konferencave shkencore, konferencave të ndryshme në nivel studentësh dhe të stafeve akademike, simpoziumeve, tribunave të përbashkëta si dhe forma tjera që të thellojnë bashkëpunimin.
6. Organizimin e konferencave me profesor dhe personalitete ndërkombëtare nga karriera diplomatike në Institucionet ndërkombëtare dhe Evropiane.
7. Në kuadër të marrëveshjes me gjithsej gjashtë pika, prioritet për jetësimin e kësaj marrëveshjeje:
   1. Konferencave, leksione, promovimin e seminareve, Gjithashtu kjo Marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin për çështje administrative, etj.
   2. Krijimin ne mundësive me profesorëve nga Evropa për të ligjëruar par studentëve në funksion të avancimit të shkollimit të lartë në Kosovë.
   3. Parashihet shkëmbimi i vizitave të stafit akademik nga Kolegji Universum që kanë për qëllim bashkëpunimin me Universitet në Zvicër, France dhe Evropë.
   4. Do të përcaktohen me protokolle të veçanta. Dhe si të tilla ato do të firmosen edhe nga përfaqësuesit e tyre kompetentë, duke krijuar mundësit me agjenda preliminare në Universitetet në Evropë.
   5. Bashkëpunimin në projekte me interes të përbashkët kërkimor studiues
   6. Shkëmbim të publikimeve shkencore në fushat, të cilat janë në interes të të dyja palëve për të përditësuar informacionin.

Prishtinë, 26 Gusht 2016.

Shoqata e Miqësisë Franko-Shqiptare

Tahir Shabani
President

Kolegji Universum

Suat Berisha
President

KOLEGJI UNIVERSUM
UNIVERSUM
PRISHTINË

KOLEGJI UNIVERSUM

INPO
Iniciativa për progres

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

midis:

Kolegji "UNIVERSUM" (kampusi Ferizaj)

dhe Iniciativa për Progres (INPO)

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese shprehin vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjelltë, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit organizata INPO do të formoj klubin e debatit në Kolegjin Universum (në kampusin e Prishtinës dhe Ferizajt), duke u mundësuar studentëve të Kolegjit Universum të përvetësojnë praktikat e mira që ka INPO në programin e debateve dhe të kontriboj në zhvillimin e mendimit kritik të studentëve të Kolegjit Universum. Në kuadër të klubit, INPO synon që të realizoj disa aktivitete trajnuese dhe programe të tjera me qëllim të arritjes së objektivave të kësaj marrëveshje.

2. INPO do të krijoj grupet e leximit me qëllim të nxitjes së diskutimit lidhur me tema me rëndësi në zhvillimin akademik dhe profesional.

3. Kolegji Universum do të ofroj qasje në bibliotekën e kolegjit për aktivistët dhe stafin e INPO-s, në varësi të kërkesës së aktivistëve të organizatës.

4. INPO do të siguroj sipas nevojës hapësirë për sudentët e Kolegjit Universum për të realizuar punën praktike, me orar të rregullë të përcaktuar nga organizata.

5. Palët nënshkruese të memorandumit zotohen të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera, me qëllim të avansimit të njohurive dhe përgatitjen e të rinjve.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

I. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

II. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë;

III. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

IV. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Ferizaj, më: 11/03/2016

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji "UNIVERSUM"
Nazim Haliti
Kordinator

KOLEGJI UNIVERSUM UNIVERSUM PRISHTINË

Iniciativa për Progres
Arbër Kadriu
Drejtor ekzekutiv

MARRËVESHJE BASHKPUNIMI

E lidhur më 10.09.2015 në Prishtinë ndërmjet

Klinikës Gjermane të dhëmbit

"Zirkon-Line Sh.p.k"

të cilën e përfaqëson Besnik Billali nga njëra anë dhe

DHE

Kolegjit UNIVERSUM

të cilën e përfaqeson Aljetin Berisha nga ana tjeter, e lidhur si vijon:

- Kolegji Univesum ia beson Klinikës Gjermane të dhëmbit ("Zirkon-Line Sh.p.k") kryerjen e të gjitha shërbimeve dentare.

- Studentet e Kolegjit "UNIVERSUM" do kryejnë shërbime në kohëzgjatje prej katër (4) vitesh.

- Klinika Gjermane e dhëmbit "Zirkon Line" për studentët e "UNIVERSUM" ofron zbritje prej 10% për të gjitha shërbimet.


- Klinika Gjermane e dhëmbit "Zirkon Line" për staffin e "UNIVERSUM" ofron zbritje prej 15% për të gjitha shërbimet.


- Klinika Gjermane e dhëmbit "Zirkon Line" merr detyrimin e kryerjes së punëve sipas marrëveshjes në mënyrë dhe në kushtet e vërtetuara me këtë marrëveshje.

Klinika Gjermane

KOLEGJI UNIVERSUM

Kartë për anëtar





Kjo Marrëveshje quhet e lidhur ditën e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.

Klinika Gjermane e dhëmbit "ZIRKON-LINE"
Besnik Bilalli

B. Bilalli

Kolegji "UNIVERSUM"
Alejtin Berisha

KOLEGJI UNIVERSUM PRISHTINË

Data 10.09.2015, Prishtinë

KOLEGJI UNIVERSUM

KOPF
Kosova Population Foundation

MARRËVESHJE PËR BASHKPUNIM

midis

Kolegjit "UNIVERSUM"- Prishtinë

dhe

Kosova Population Foundation KOPF – Prishtinë

I. Qëllimi i Marrëveshjes

1. Me këtë marrëveshje palët nënshkruese kanë shprehë vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar përkrahjen e maturantëve të shkollave të mesme të Kosovës përmes organizimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta;
2. Palët nënshkruese në kuadër të bashkëpunimeve marrin përsipër bashkëpunimin në organizim e "Love Plus Streetball-it" **(tash e tutje aktivitet)**, i cili do të mbahet rreth datës **18.05.2013** në pishinën e Gërmisë në Prishtinë, ku parashihet të jenë të pranishëm **2500** deri **3000** maturantë të shkollave të mesme të Kosovës;
3. Ky aktivitet organizohet tradicionalisht nga KOPF me përkrahje të donatorëve të ndryshëm institucional dhe privat;
4. Kolegji "Universum" siguron përkrahjen në këtë organizim përmes ofrimit të bursave për studime universitare baçelor për ekipin fitues të aktivitetit dhe lojtarin më të mirë të zgjedhur nga komisioni vlerësues;
5. KOPF siguron përfshirjen e Kolegjin "Universum" në të gjithë materialet promovues dhe lejon vendosjen e një shtandi në pishinën e Gërmisë për promovim të Kolegjit "Universum" gjatë datës së mbajtjes së këti aktiviteti.

A.B

KOLEGJI UNIVERSUM * UNIVERSUM * PRISHTINË

II. Fushëveprimtaria

Bashkëpunimi i ndërsjellët i palëve do të realizohet në këto fusha:

1. Organizimi i përbashkët i aktiviteteve në fusha të ndryshme rekreative, kulturore si dhe trajnime në fusha të caktuara;
2. Qasje në projekte të ndërsjella, nëpërmjet të cilave do t'u mundësohet pedagogëve, maturantëve, studentëve dhe stafit udhëheqës dhe menaxhues, të kenë mundësi të përfshihen në projekte të përbashkëta që do të ndërmerren nga Kolegji "Universum" dhe KOPF;

III. Ndarja e bursave për fituesit (procedurat dhe kriteret)

1. Kolegji "Universum" për lojtarin më të mirë ofron bursë të plotë (100%) studimi për programin baçelor dhe bursë (70%) për katër (4) lojtaret e ekipit fitues te garës ne programin baçelor;
2. Ne rast se lojtaret fitues te garës nuk janë maturant, Kolegji "Universum" garanton se do t'ua ruaj bursat derisa ta mbarojnë shkollën e mesme dhe t'u mundësoj vazhdimin e studimeve ne Kolegjin "Universum" sipas nenit te lartcekur;
3. Nëse ndonjëri (apo me shume) prej lojtarëve te ekipit fitues veçse ka mbaruar studimet baçelor dhe dëshiron ta transferoje bursën e fituar te ndonjë anëtar i familjes apo person tjetër fizik i cili duhet të jetë maturant, Kolegji "Universum" do t'ia beje te mundur këtë por duke e zbritur përqindjen e bursës nga 70% ne 50% dhe duke e shfrytëzuar bursën për vitin akademik 2013/2014;
4. Të gjitha bursat zyrtarizohen përmes vendimit dhe kritereve të Kolegjit "Universum" të determinuar me kontratë të studimeve ndërmjet fituesit dhe Kolegjit "Universum", ku kërkohet nga maturantët të kenë të paktën suksesin **shkëlqyeshëm** apo **shumë mirë** për shfrytëzim të bursës;
5. Fituesit e bursave obligohet që gjatë studimeve ta ruajnë bursën përmes kritereve të përcaktuara me kontratë dhe gjithashtu të kryejnë të paktën 200 orë pune për Kolegjin "Universum" gjatë një viti akademik.
6. Kolegji "Universum" e ka të drejtën e caktimit të një anëtari nga stafi në komisionin vlerësues gjatë përzgjedhjes së lojtarit dhe ekipit më të mirë.
7. Kolegji "Universum" do te ndaje certifikata për lojtarin me te mire dhe katër lojtaret e ekipit fitues, ne te cilat ceket bursa e fituar dhe përqindja e saj, certifikate kjo e cila do te shërbeje si dëshmi, me te cilën fituesit mund te paraqiten ne Kolegjin "Universum" për ta zyrtarizuar bursën dhe nënshkruar kontratën e studimeve.

A. B

KOLEGJI UNIVERSUM UNIVERSUM PRISHTINË

IV. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas kësaj Marrëveshje, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Marrëveshje apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë;
3. Në rast të përfshirjes së kolegjeve tjera në materialin promovues dhe ndarjes së hapësirës për promovim, kjo marrëveshje konsiderohet e pa vlefshme nga ana e Kolegjit "Universum".

V. Dispozitat e Fundit

1. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e kësaj Marrëveshje do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe brenda kuadrit të etikës morale, përveç në rastet e paraqitura në pjesën IV paragrafi tre (3);
2. Kjo Marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit;
3. Kjo Marrëveshje është përpiluar në katër kopje identike, dhe secila palë merë nga dy kopje.

Prishtinë, më 19.04.2013

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji "UNIVERSUM"
Alejtin Berisha
Drejtor Ekzekutiv

KOPF
Përfaqësuar nga:
për Rijat Batusha

Memorandum of Understanding (MOU)
Between
"Me dorë në zemër"

And
Universum University College, KOSOVA

KOLEGJI UNIVERSITAR
UNIVERSUM

NGO "Me dorë në zemër" and Universum University College (UUC) do hereby agree to design, develop and implement the details of the following memorandum of understanding (MoU).

This **MoU** is based on the reciprocity principle and expresses the genuine interests of both parties in implementing the project "Public Awareness Campaign on Reducing the Health Risk from the Exposure on Lead", in the hope and belief that this project will be substantially important to the wellbeing of the Kosovo's community.

1. **UUC** and **NGO "Me dorë në zemër"** will work closely to accomplish the following project results:
    - Conduct an awareness campaign that educates a large target group;
    - Increase awareness of those exposed the most;
    - Help develop preventive skills;
    - Reduce the amount of people exposed to lead;
    - Boost the cooperation within municipalities, communities and between different agencies and businesses that are involved in mining..

2. In order to achieve project objectives the

UUC will be responsible to:

- Conduct a desk study to collect data about previous research project concerning lead pollution and the findings will serve as the background information which later will be used as a material for informing and training the residents concerned about living with lead;
- Organise the public awareness campaign in order to educate residents exposed to lead about the impact of lead pollution, ways of prevention and get help; and to initiate dialogue with local municipalities for further support;
- Produce a mini- movie (3-4 minutes) including important facts and figures regarding the impact of environmental health exposure the health and possible precautions;

whereas, **NGO"Me dorë në zemër"** will be responsible to:

- Organize trainings and workshops which will be focused on educating NGOs, Municipality Workers Health Sector, Social Workers and Pre-schools, Elementary Schools and high Schools childrens about the main sources of lead eksposure, extent of lead poisoning in children, main environmental fate of lead, bioavailability of lead, soil characterizations, metabolic interactions etc;
- Organize fairs (open-table), twice a week, in each municipality and destribute flyers and leaflets;
- Submiting a report for End-of-Workshop surveys for all focus groups

3. Both parties will work together in identifying local Radio's, TV's and location of the billboard which will be used during the awareness campaign.

4. Both parties will work together in every difficulty which will be presented during the implementation of the project.

5. Both parties recognize that the implementation of this **MoU** will depend on the financial resources.

6. This agreement becomes effective when signed by the representatives of the two parties. The agreement shall remain in effect for a period of six months.

7. Any articles in this agreement may be amended or revised by the two universities after consultation and mutual agreement. Any issues not mentioned in this agreement may be resolved through mutual agreement.

Subsequent to this agreement, a more specific implementation plan will be drafted which outlines all activities that are to occur under this collaborative effort.

For **Universum University College**

Alejtin Berisha
Executive Director

Date 09.08.2012

For the **NGO "Me dorë në zemër"**

Shqipe Qarkaj - Kadriu
Executive Director

Date 09.08.2012

ENCOMPASS
Qendra për Studime dhe Shërbime Psikologjike dhe Sociale
Centre for Psychological and Social Studies and Services

Kolegji UNIVERSUM
UNIVERSUM College

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

ndërmjet

KOLEGJIT UNIVERSUM

dhe

QENDRËS PËR STUDIME DHE SHËRBIME PSIKOLOGJIKE DHE SOCIALE ENCOMPASS

Neni 1
Qëllimi

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e mëtejmë Memorandumi), i lidhur ndërmjet Qendrës për Studime dhe Shërbime Psikologjike dhe Sociale – ENCOMPASS (në tekstin e mëtejmë Qendra ENCOMPASS) dhe Kolegjit UNIVERSUM (në tekstin e mëtejmë UNIVERSUM), nënshkruhet me qëllim të krijimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit në mes të këtyre dy institucioneve në funksion të përkrahjes së Projektit ATOMI, i cili implementohet nga Qendra ENCOMPASS dhe i cili ka për qëllim identifikimin dhe përkrahjen e personave me inteligjencë të jashtëzakonshme në Kosovë.

Projekti ATOMI është miratuar dhe përkrahet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe do të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe në përputhje me kriteret dhe standardet më të larta shkencore, profesionale dhe etike.

Neni 2
Përgjegjësitë e UNIVERSUM-it:

2.1. Mbështetje e përgjithshme për Projektin ATOMI

1. UNIVERSUM do ta mbështesë Projektin ATOMI në të gjitha format dhe drejtimet, brenda kompetencave, mundësive dhe kapaciteteve të veta.

2. UNIVERSUM do t'i ofrojë Qendrës ENCOMPASS mundësinë për t'i shfrytëzuar hapësirat universitare të UNIVERSUM-it për aktivitetet e parapara të Projektit ATOMI, siç janë: testimet, trajnimet dhe takimet me nxënës, prindër dhe mësimdhënës.

2.2. Mbështetje për 50-60 nxënësit më të mirë dhe më të suksesshëm të përzgjedhur në fund të ciklit vjetor të Projektit ATOMI

1. UNIVERSUM do t'ju mundësojë këtyre nxënësve qasje në të gjitha bibliotekat (databazat) elektronike ku ka qasje UNIVERSUM dhe në bibliotekën universitare të UNIVERSUM-it, në mënyrë që këta nxënës të kenë në dispozicion resurse të literaturës vendore e ndërkombëtare.

2. UNIVERSUM do t'ju ofrojë këtyre nxënësve mundësinë që të marrin pjesë në ligjërata, seminare, punëtori e konferenca që organizohen nga UNIVERSUM, në mënyrë që këta nxënës të kenë mundësi që të zgjerojnë dhe avancojnë njohuritë dhe kompetencën e tyre në fushat e tyre të interesimit.

3. UNIVERSUM do t'ju ofrojë 10 prej këtyre nxënësve, të cilët janë të interesuar në fushën e teknologjisë informative dhe në gjuhën angleze, mundësinë që të vijojnë pa pagesë trajnimet nga këto fusha, të cilat organizohen nga UNIVERSUM dhe ku këta nxënës do të kenë mundësinë që të avancojnë kompetencën e tyre në fushën e TI dhe të gjuhës angleze .

4. Me rastin e aplikimit të këtyre nxënësve për studime në UNIVERSUM, UNIVERSUM do t'i ketë parasysh dhe do t'ju jap përparësi këtyre nxënësve për pranim për studime në UNIVERSUM, në përputhje me kriteret dhe standardet e UNIVERSUM-it.

2.3. Mbështetje për të përzgjedhurit e Projektit ATOMI, të cilët do të regjistrohen dhe do të vijojnë studimet në UNIVERSUM

1. UNIVERSUM do t'ju ofrojë bursë universitare tetë (8) studentëve që do të regjistrohen për studime në UNIVERSUM (nga 2 bursa për secilin kampus të UNIVERSUM-it, në Prishtinë, Ferizaj, Prizren dhe Gjakovë).

1.1. UNIVERSUM do të ofrojë një (1) bursë të plotë për shkollimin e mesëm.

2. Të gjithë atyre studentëve që dëshmojnë rezultate shumë të mira në vitin e parë të studimeve në përputhje me kriteret e UNIVERSUM-it, UNIVERSUM do t'ju ofrojë mundësinë që një pjesë të studimeve t'i kryejnë në universitete të ndryshme jashtë vendit, përmes projekteve ekzistuese për mobilitet të studentëve.

AB

Neni 4
Zbatueshmëria

Pas nënshkrimit, ky Memorandum i përcillet për zbatim personave përgjegjës të të dyja palëve nënshkruese të këtij Memorandumi.

Neni 5
Numri i kopjeve identike të memorandumit

Memorandumi nënshkruhet në katër (4) kopje identike, nga dy (2) kopje për secilën palë të Memorandumit, të cilat kanë forcë të njëjtë juridike.

Hyrja në fuqi

Memorandumi i Mirëkuptimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatohet nga data 1 maj 2013.

Palët e nënshkruajnë Memorandumin në Prishtinë, me datën: 30 prill 2013

Për UNIVERSUM

Alejtin Berisha
Drejtor Ekzekutiv

Për ENCOMPASS

Thaçi

Jusuf Thaçi
Drejtor Ekzekutiv

J.Th.

AB

KOLEGJI UNIVERSUM

SBASHK

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

midis

Kolegjit ''UNIVERSUM''- Prishtinë

Dhe

SBASHK (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës e Kosovës)- Prishtinë

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Me anë të këtij memorandumi, Kolegji Universum merr përsipër ofrimin e bursave të pjesërishme akademike për anëtarët e SBASHK-ut dhe familjaret e tyre.

2. Bursat ofrohen 30% për nivelin Baçelor për tri vite studimi dhe nivelin Master per dy vite studimi. Ata të cilët kanë përfunduar baçelor sistemin tre vjeçar atëherë studimet master zgjasin dy vite, ndërsa nëse kanë përfunduar studimet bacelor sistemin katër vjeçar atëherë studimet master zgjasin një vit.

   Shuma e paraparë mund të paguhet deri me 12 këste.

3. Me anë të këtij memorandum mirëkuptimi SBASHK dhe Kolegji Universum do të bashkëpunojnë në aplikime për grante nga organizatat ndërkombëtare siq janë USAID, UNDP, Komisioni Evropiane etj.

4. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, palët dakordohen që të bëjnë shkëmbimin e stafit **(në raste të caktuara)** për pjesëmarrje në ligjërata publike apo evenimente të organizuara në frymën profesionale.

III. Përzgjedhja e Kandidatëve për Bursa

Përzgjedhja e përfituesve të bursave do të bëhet nga SBASHK duke respektuar kriteret e përgjithshme. Përvoja paraprake dhe mundësia e kandidatëve për tu ngritur në karrierë duhet të merren parasysh gjatë procesit të përzgjedhjes. Preferohet që përzgjedhja e kandidatëve të mos koncentrohet në një departament apo nivel të menaxhmentit. Preferohet që të ketë diversitet (gjinor, etnik, fetar dhe social) gjatë përzgjedhjes së kandidatëve. Kandidatet e përzgjedhur duhet te posedojnë kontratën e punës valide me institucione arsimore ose në rast se është familijar autorizim nga personi i punesuar ne Institucione arsimore si dhe kopjen e kontrates me Institucionin arsimor.

V. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

I. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

II. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë;

VI. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

VII. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

PALËT NËNSHKRUESE

Prishtinë, më 29/Tetor/2014

Alejtin Berisha

Drejtor Ekzekutiv
Kolegji Universum

Rrahman Jasharaj

Kryetar i SBASHK

SBASHK - Sindikata e Bashkuar e Arsimit e Shkencës dhe e Kulturës së Kosovës
UESCK - The Union of Education, Science and Culture of Kosova

KOLEGJI UNIVERSUM

Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

MARRËVESHJE PËR BASHKPUNIM

midis

Kolegjit "UNIVERSUM"

dhe

Shoqata e të Verbërve të Kosovës-SHVK

I. Qëllimi i Marrëveshjes

1. Me këtë marrëveshje palët nënshkruese kanë shprehë vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, ndarjen e përvojave në fushën e edukimit dhe organizimeve;

2. Palët e kësaj marrëveshje, gjithashtu zotohen për bashkëpunim në fusha të ndryshme, që ndërlidhën me aktivitetet e edukimit, shkëmbimin e stafit profesional ndërmjet Shoqatës së të Verbërve të Kosovws dhe Kolegjit "Universum";

3. Avancimin e mësimdhënies dhe mësimnxënjës për kategorinë e personave të verbër, përmes metodateve të reja dhe një qasje të re ndaj kësaj kategorie;

4. Bashkëpunimi për arritjen e një ambienti ku të gjitha kanë qasje në arsimim dhe zhvillim të mëtutjeshëm pa diskriminim, mbështetur në parimet e Ligjit për Arsimin e Lartë, Ligjit për Personat e Verbër, si dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës;

5. Kolegji "Universum" në kuadër të kësaj marrëveshje dhe mbështetjes fillestare së kategorisë së personave të verbër, ofron zbritje në regjistrim në vlerë prej 20%, për

nivelin e studimeve baçelor dhe master. Kjo zbritje mund të shfrytëzohet edhe për familjarët e pjesëtarëve të kësaj kategorie.

II. Fushëveprimtaria

Bashkëpunimi i ndërsjellt mes palëve do të realizohet në këto fusha:

1. Organizimi i përbashkët i aktiviteteve në fusha të ndryshme shkencore, ekonomike, politike dhe kulturore nëpërmjet simpoziumeve, konferencave, debateve;
2. Qasje në projekte të ndërsjellta, nëpërmjet të cilave do t'u mundësohet pedagogëve, studentëve dhe stafit udhëheqës dhe menaxhues të dy subjekteve bashkëpunuese, të kenë mundësi të përfshihen në projekte të përbashkëta;
3. Mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara përmes metodave të reja dhe metodave të reja, sipas standardeve Evropiane dhe Ndërkombëtare;
4. Organizimin e konferencave për promovimin e edukimit të personave të verbër të Kosovës, si dhe aktivitete tjera që ndërlidhën me edukimin e kësaj kategorie dhe përfshirjen e tyre në komunitetin universitar;
5. Konkurrimin në projekte të përbashkëta vendore, ndërkombëtare, nëse mesë palëve ekziston vullneti dhe dëshira.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas kësaj marrëveshje, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument.
2. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Marrëveshje apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër.
3. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë.

IV. Dispozitat e Fundit

1. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e kësaj Marrëveshje do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe brenda kuadrit të etikës morale;
2. Kjo Marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit;
3. Kjo Marrëveshje është përpiluar në katër kopje identike, dhe secila palë merë nga dy kopje.

Prishtinë, më 26.03.2014

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji ''UNIVERSUM''
Drejtor Ekzekutiv

Z. Alejtin Berisha

Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Përfaqësuar nga:

Z. Bujar Kadriu

KOLEGJI UNIVERSUM

SBASHK

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

midis

Kolegjit ''UNIVERSUM''- Prishtinë

Dhe

SBASHK (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës e Kosovës)- Prishtinë

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Me anë të këtij memorandumi, Kolegji Universum merr përsipër ofrimin e bursave të pjesërishme akademike për anëtarët e SBASHK-ut dhe familjaret e tyre.

2. Bursat ofrohen 30% për nivelin Baçelor për tri vite studimi dhe nivelin Master per dy vite studimi. Ata të cilët kanë përfunduar baçelor sistemin tre vjeçar atëherë studimet master zgjasin dy vite, ndërsa nëse kanë përfunduar studimet bacelor sistemin katër vjeçar atëherë studimet master zgjasin një vit.

   Shuma e paraparë mund të paguhet deri me 12 këste.

3. Me anë të këtij memorandum mirëkuptimi SBASHK dhe Kolegji Universum do të bashkëpunojnë në aplikime për grante nga organizatat ndërkombëtare siq janë USAID, UNDP, Komisioni Evropiane etj.

4. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, palët dakordohen që të bëjnë shkëmbimin e stafit **(në raste të caktuara)** për pjesëmarrje në ligjërata publike apo evenimente të organizuara në frymën profesionale.

III. Përzgjedhja e Kandidatëve për Bursa

Përzgjedhja e përfituesve të bursave do të bëhet nga SBASHK duke respektuar kriteret e përgjithshme. Përvoja paraprake dhe mundësia e kandidatëve për tu ngritur në karrierë duhet të merren parasysh gjatë procesit të përzgjedhjes. Preferohet që përzgjedhja e kandidatëve të mos koncentrohet në një departament apo nivel të menaxhmentit. Preferohet që të ketë diversitet (gjinor, etnik, fetar dhe social) gjatë përzgjedhjes së kandidatëve. Kandidatet e përzgjedhur duhet te posedojnë kontratën e punës valide me institucione arsimore ose në rast se është familijar autorizim nga personi i punesuar ne Institucione arsimore si dhe kopjen e kontrates me Institucionin arsimor.

V. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

I. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

II. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë;

VI. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

VII. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

PALËT NËNSHKRUESE

Prishtinë, më 29/Tetor/2014

Alejtin Berisha

Drejtor Ekzekutiv
Kolegji Universum

KOLEGJI UNIVERSUM * UNIVERSUM * PRISHTINË

Rrahman Jasharaj

Kryetar i SBASHK

SBASHK

MARRËVESHJE

E nënshkruar në mes të:

Kolegji RIINVEST
dhe
Kolegji UNIVERSUM

Neni 1
Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje midis Kolegjit RIINVEST dhe Kolegji Universum nënshkruhet me qëllim të përmbushjes së obligimit sipas Nenit 14, Pika 5.8. Të Ligjit mbi Arsimin e Lartë (Ligji Nr.04/L037).

Neni 2
Subjekti i marrëveshjes
Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje sipas nenit paraprak pajtohen se në rast falimentimi apo të tërheqjes së akreditimit të programeve të njërit apo tjetrit institucion të arsimit të lartë do të pranojnë transferimin e studentëve të programeve të ngjashme të njërit institucion në programet e ngjashme të tjetrit institucion të akredituar dhe anasjelltas.

Neni 3
Hyrja në fuqi
Kjo marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa zbatohet në rast të përmbushjes së kushteve sipas Nenit 2 të kësaj marrëveshje.

Neni 4
Kjo marrëveshje nënshkruhet në 4 kopje.

Secila palë nënshkruese nga një kopje të kësaj marrëveshje e dërgojnë në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës.

Prishtinë,
26.09.2014

Palët nënshkruese:

Kolegjin RIINVEST

Bardhyl Metaj, Drejtor ekzekutiv

Kolegji Universum

Alejtin Berisha, Drejtor ekzekutiv

KOLEGJI UNIVERSUM

BPAL - PHEI
KOLEGJI - COLLEGE
"GJILANI"
Gjilan

MEMORANDUM PËR BASHKPUNIM DHE NJOHJE TË NDËRSJELLTË

midis

Kolegjit "UNIVERSUM"- Prishtinë

dhe

Kolegjit "GJILANI"- Gjilan

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Me këtë memorandum palët nënshkruese kanë shprehë vullnetin e mirë dhe gadishmërin për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas;
2. Me anë të këti Memorandumi palët nënshkruese marinë për obligim bartjen përkatësisht transferimin e studentëve në rast të falimentimit apo tërheqjes së akreditimit e përkufizuar sikurse në ligjin mbi arsimin e lartë në nenin 14 pika 5.8.
3. Në rastet e parapa në paragrafin dy të këti neni dhe ligjin mbi arsimin e lart në nenin 14 pika 5.8. ku decidivisht kërkohet që bartësit e lartë të kenë marrëveshje me të paktën dy Kolegje, palët nënshkruese të kësaj marrëveshje marinë për obligim dhe zotohen që për programet e specifikuara ne tabel do ta bejne trasnferimin e studenteve ne rastet e parapara ne piken II te keti neni.

Kolegji "UNIVERSUM"	Kolegji "GJILANI"
• **Biznes dhe Menaxhmet (BA)** me specializime • **Biznes dhe Menaxhment (MA)** me specializime	• **Banka,financa dhe kontabilitet (BA)** • **Menaxhment (BA/MA)**
• **Administrat Publike dhe Marredhenie Nderkombetare (BA)** • **Juridik dhe Menaxhment (BA)**	• **Juridik(LLB)**

II. Fushëveprimtaria

Bashkëpunimi i ndërsjellët i palëve do të realizohet në këto fusha:

1. Shkëmbimi i përvojave akademike të Kolegjit ''UNIVERSUM'' dhe Kolegjit ''GJILANI'', me qëllim arritjen e standardeve bashkëkohore në fushat të ndryshme Universitare;
2. Shkëmbimi i studentëve të Kolegjit ''UNIVERSUM'' dhe Kolegjit ''GJILANI'';
3. Bartja e studentëve në rastet se ndaj palëve nënshkruese Agjencioni i Akreditimit të Kosovës fillon procedurat e heqjes së akreditimit apo rastet e tjera të parapara në pikën dy (2), neni (I) të këtij Memorandumi dhe ligjin mbi arsimin e lartë publik;
4. Organizimi i përbashkët i aktiviteteve në fusha të ndryshme shkencore, ekonomike, politike dhe kulturore nëpërmjet simpoziumeve, konferencave, debateve;
5. Qasje në projekte të ndërsjellta, nëpërmjet të cilave do t'u mundësohet pedagogëve, studentëve dhe stafit udhëheqës dhe menaxhues, të kenë mundësi të përfshihen në projekte të përbashkëta që do të ndërmerren nga Kolegji ''UNIVERSUM'' dhe Kolegji ''GJILANI'';
6. Konkurrimi në projekte të përbashkëta vendore, ndërkombëtare, nëse mesë palëve ekziston vullneti dhe dëshira.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër.
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë.

IV. Dispozitat e Fundit

1. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe brenda kuadrit të etikës morale;
2. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit;
3. Ky Memorandum është përpiluar në katër kopje identike, dhe secila palë merë nga dy kopje.

Prishtinë, më 03.06.2012

Akt en brevet nr.ref.0040/12

Sot, më datë KATËRMBËDHJETË QERSHOR DY MIJË E DYMBËDHJETË, ditën e Hënë, para meje, Arbena Shehu, Noter ME SELI NË PRISHTINË, Rruga Garibaldi numër 7/1, vërteton se: ----------

Nënshkrimin e Z.Visar Kastratit i cili me autorizim e përfaqëson Z.Suat Berisha memorandumin për bashkpunim dhe njohje të ndërsjelltë midis Kolegjit "Universum" – Prishtinë dhe Kolegjoit "Gjilani" në Gjilan, vërtetoj se ky nënshkrim është vënë nga Z.Visar kastratit i LINDUR NË PRISHTINË ME tre shkurt NJËMIJË E NËNTËQIND E TETËDHJETË E SHTATË, NGA I ATI LULZI, ME PROFESION JURIST, VENDBANIM TË PËRHERSHËM NË PRISHTINË, RR"REXHEP MALA, NUMËR 17, IDENTITETI I TË CILËS KONSTATOHET NGA LETËRNJOFTIMI ME NUMËR PERSONAL 2173213037 I LËSHUAR NGA MPB ME DATË 14.04.2009, i cili gëzon ushtrimin e të drejtave të tija të veprimit.--------
Veprimi i noterizimit u kryc në Prishtinë, në selinë e Noteres Arbena Shehu në adresën e lartëshënuar me datën katërmbëdhjetë qershor dy mijë e dymbëdhjetë. ----------
---

NOTERJA

Arbena Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA * REPUBLIC OF KOSOVO * ODA E NOTERËVE TË KOSOVËS * NOTARSKA KOMORA KOSOVA * NOTARY CHAMBER OF KOSOVO * PRISHTINË PRISHTINA ARBENA H. SHEHU NOTER 1

Visar Kastrati

KOLEGJI UNIVERSUM

KOLEGJI VICTORY

MARRËVESHJE PËR TRANSFERIM TË STUDENTËVE DHE NJOHJE TË NDËRSJELLËT

midis

Kolegjit "UNIVERSUM"- Prishtinë

dhe

Kolegjit "VICTORY"- Prishtinë

I. Qëllimi i Marrëveshjes

1. Me këtë marrëveshje palët nënshkruese kanë shprehë vullnetin e mirë dhe gadishmërin për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas;
2. Me anë të kësaj marrëveshje palët nënshkruese marrin për obligim bartjen përkatësisht transferimin e studentëve në rast të falimentimit apo tërheqjes së akreditimit e përkufizuar sikurse në ligjin mbi arsimin e lartë në nenin 14 pika 5.8;
3. Në rastet e parapa në paragrafin dy të këti neni dhe ligjin mbi arsimin e lart në nenin 14 pika 5.8. ku decidivisht kërkohet që bartësit e lartë të kenë marrëveshje me të paktën dy Kolegje, palët nënshkruese të kësaj marrëveshje marrin për obligim dhe zotohen që për programin e specifikuara ne tabelë do ta realizojnë transferimin sipas dispozitave te kesa marrëveshje dhe ligjit mbi arsimin e lartë.

Kolegji "UNIVERSUM"	Kolegji "VICTORY"
Administratë Publike, Marrëdhënie ndërkombëtare (BA)	Politikë Ndërkombëtare, Diplomaci (BA)
E Drejta dhe Menaxhmenti (BA)	Juridik (BA)

II. Fushëveprimtaria

Bashkëpunimi i ndërsjellët i palëve do të realizohet në këto fusha:

1. Shkëmbimi i përvojave akademike të Kolegjit "UNIVERSUM" dhe Kolegjit "VICTORY", me qëllim arritjen e standardeve bashkëkohore në fushat të ndryshme Universitare;
2. Shkëmbimi i studentëve të Kolegjit "UNIVERSUM" dhe Kolegjit "VICTORY";
3. Bartja e studentëve në rastet se ndaj palëve nënshkruese Agjencioni i Akreditimit të Kosovës fillon procedurat e heqjes së akreditimit apo rastet e tjera të parapara në pikën dy (2), neni (I) të kësaj marrëveshje dhe ligjin mbi arsimin e lartë publik;
4. Organizimi i përbashkët i aktiviteteve në fusha të ndryshme shkencore, ekonomike, politike dhe kulturore nëpërmjet simpoziumeve, konferencave, debateve;
5. Qasje në projekte të ndërsjella, nëpërmjet të cilave do t'u mundësohet pedagogëve, studentëve dhe stafit udhëheqës dhe menaxhues, të kenë mundësi të përfshihen në projekte të përbashkëta që do të ndërmerren nga Kolegji "UNIVERSUM" dhe Kolegji "VICTORY";
6. Konkurrimi në projekte të përbashkëta vendore, ndërkombëtare, nëse mes palëve ekziston vullneti dhe dëshira.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas kësaj marrëveshje, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë marrëveshje apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër.
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë.

IV. Dispozitat e Fundit

1. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe brenda kuadrit të etikës morale;
2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit;
3. Kjo marrëveshje është përpiluar në katër kopje identike, dhe secila palë merë nga dy kopje.

Prishtinë, më 19.06.2012

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji "UNIVERSUM"

Kryetari i Bordit, te cilin me autorizim e përfaqëson Visar Kastrati

z. Suat BERISHA

Kolegji "Victory"

Rektori, te cilin me autorizim e përfaqëson Vjollca Salihu

z. Bedri Selmani

Akt en brevet nr.ref.0051/12

Sot, më datë NËNTËMBËDHJETË QERSHOR DY MIJË E DYMBËDHJETË, ditën e Martë, para meje, Arbena Shehu, Notere ME SELI NË PRISHTINË, Rruga Garibaldi numër 7/1, vërteton se: ----------

---

Nënshkrimin e Z.Visar Kastrati i cili me autorizim e perfaqeson Z.Suat Berisha Kryetari i Bordit të Kolegjit Universum i njejti ka nenshkruar Marrëveshje për transferim të studentëve dhe njohje të ndërsjellët midis Kolegjit Universum dhe Kolegjit Victory-Prishtinë , vërtetoj se ky nënshkrim është vënë nga Z.Visar Kastrati i lindur në Prishtinë me tre shkurt njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë, nga i ati Lulzim, me profesion Jurist, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, Rr."Rexhep Mala", nr.17, identiteti i të cilit konstatohet nga letërnjoftimi me numër personal 2173213037 i lëshuar nga MPB më datë 14.04.2009, i cili gëzon ushtrimin e të drejtave të tija të veprimit.(Autorizimi i Z.Visar kastrati ipet/vlen vetem per nenshkrimin e marreveshjeve ndermjet Universiteteve eshte i vulosur me vuke te Kolegjit Universum dhe e nenshkruar))----------

---

Veprimi i noterizimit u krye në Prishtinë, në selinë e Noteres Arbena Shehu në adresën e lartëshënuar me datën nëntëmbëdhjetë qershor dy mijë e dymbëdhjetë. ----------

---

NOTERJA

Arbena Shehu

Visar Kastrati

Akt en brevet nr.ref.0051/12

Sot, më datë NËNTËMBËDHJETË QERSHOR DY MIJË E DYMBËDHJETË, ditën e Martë, para meje, Arbena Shehu, Notere ME SELI NË PRISHTINË, Rruga Garibaldi numër 7/1, vërteton se: ----------

---

Nënshkrimin e Vjollca Salihu e cila me autorizim e perfaqeson Rektorin e Kolegjit Victory Z.Bedri Selmani i e njejta ka nenshkruar Marrëveshje për transferim të studentëve dhe njohje të ndërsjellët midis Kolegjit Universum dhe Kolegjit Victory-Prishtinë, vërtetoj se ky nënshkrim është vënë nga Vjollca Salihu e lindur në Prishtine me njëzet e gjashtë një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre, nga i ati Xhemajl, me profesion juriste, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, Rr."Ulpiana D1, hyrja 10 nr.10, identiteti i të cilit konstatohet nga letërnjoftimi me numër personal 1011359619 i lëshuar nga MPB më datë 02.02.2010, i cili gëzon ushtrimin e të drejtave të tija të veprimit.----------

---

Veprimi i noterizimit u krye në Prishtinë, në selinë e Noteres Arbena Shehu në adresën e lartëshënuar me datën tetëmbëbëdhjetë qershor dy mijë e dymbëdhjetë. ----------

---

NOTERJA

Arbena Shehu

Vjollca Salihu

Komuna Mitrovicë

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NË MES TË
ALEANCA KOSOVARE E BIZNESEVE
Kolegji " UNIVERSUM"- PRISHTINË,

DHE

KOMUNA E MITROVICES

Për bashkëpunimin dhe njohje të ndërsjella

I . Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

1. **Aleanca Kosovare e Bizneseve** ne kuadër te Jave te biznesit Kombëtare dhe 100 vjetorit te Pavarsis se Shqipëris ne bashkëpunim me **Universitetin Universum** ndanë 5 bursa për qytetaret e Komunës se Mitrovicës dhe këta do te kenë mundësi te studiojnë ne viti universitare 2012/2013 pa pagesë për profesione te ndryshme pranë keti universiteti.
2. Me këtë Memorandum palët nënshkruese kanë shprehë vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjella, me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të mëtejmë të njohurive profesionale dhe akademike, si dhe me qëllim të ndërlidhjes së mësimit akademik me punën praktike dhe anasjelltas;

2. Realizimi i këtij qëllimi do të arrihej përmes përcaktimit të një plani të dinamikës së veprimit i cili do të harmonizohej paraprakisht nga te trija palët t dhe si i tillë do të ishte pjesë përbërëse e këtij Memorandumi;

II. Fushë veprimtaria

Bashkëpunimi i ndërsjellë i palëve do të realizohej në këto fusha veprimi:

Në konsideratë të bashkëpunimit të deritanishëm me komunen e e juaj, në veçanti me Drejtorin Departamentit të Arsimit, Këshilli Drejtues i Kolegjit Universitar Universum në mbështetje të arsimimit të të rinjëve nga komuna e juaj, ka vendosur të jap 5 bursa të plota për studime universitare për vitin akademik 2012/2013 për matuaratët nga komuna e juaj dhe atë:

- **për shërbyes civil te Komunës , 1 bursë**
- **për familje të dëshmorëve, 1 bursë**
- **për invalid të luftës, 1 bursë**
- **për maturantë në asistencë sociale, 1 bursë**
- **për maturantët e shkollave të mesme, 1 bursë**

Përzgjedhja e përfituesve të bursave duhet të bëhet nga Komuna e Mitrovices, duke respektuar kriteret e përgjithshme si dhe e preferueshme është edhe suksesi nga shkollimi paraprak (shkëlqyeshëm dhe shembullorë).

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacionit

2. ASAU është themeluar nga Qendra Kosovare për Marketing dhe Menaxhim (QKEMM) në maj të vitit 2005. QKEMM-i është aktiv në fushën e kërkimeve, trajnimeve dhe botimeve profesionale e shkencore që nga janari i vitit 2000. Që prej atëherë është angazhuar në organizimin dhe mbajtjen e seminareve për stafin ekzekutiv dhe pesonelit kerkimor në ndërmarrjet dhe institucionet kosovare, ka botuar Fjalorin angisht-shqip dhe shqip-anglisht të biznesit, i pari dhe edhe sot i vetmi i këtij lloji; themeluesi i tij ka përvojë të gjatë në mësimdhënie në studimet postdiplomike dhe udheheqje akademike të doktorantëve në universitetet me renome ndërkombëtare në Evropë, Australi, Azi dhe SHBA, ka botuar një numër të madh artikujsh shkencorë në revistat shkencore ndërkombëtare me reputacion (ShBA) në gjuhen angleze, ka kontribuar substancialisht në fillimin e Programit Master në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë, dhe gëzon reputacion të pakontestushem shkencor në vend dhe jashtë vendit.

3. Ekziston një numër i vogël, por në rritje, i kandidatëve të cilët do të mund të ndjekin mësimet në gjuhen angleze në programin master dhe të doktoratës, kurse mësimi ne gjuhen agleze është esencial për transferin e krediteve në frymen e Deklaratës së Bolonjës për hapsirën unike evropiane të arsmit të lartë.

4. Ofrimi i programeve të avansuara postdiplomike për master dhe doktoratë nga ana e ASAU-së në ambientet e Kolegjit Universitar "Universum" do t'u ofrojnë asistentëve të

këtij Kolegji mundësinë që dretjtpërejti t'i aplikojnë njohuritë e tyre të fituara në studime në procesin pedagogjik gjatë punës së tyre me studentët në studimet themelore.

5. Me bashkëpunimin strategjik, të dy partnerët strategjik do të vejnë efektivisht në shërbim të njëri tjetrit resurset materiale e kadrovike, pervojen në menaxhim të mësimdhënies dhe udhëheqjes shkencore të studentëve, si dhe të organizimit të punës kërkimore-shkencore e botuese.

6. Ky bashkëpunim sjell efekte shumë positive për Kolegjin Universitar "Universum", shprehimisht bashëpunimi:

   a. ndihmon ngritjen e mëtejme të reputacionit të Kolegjit Universitar "Universum" si rezultat i kompletimit të hershëm të programeve të avansuara të studimeve për master dhe doktoratë nëpërmjet të partnerit strategjik, d.m.th. afirmon programet e studimeve themelore që planifikon të ofrojë Kolegji, duke kompletuar ato me të gjitha programet studimore të mundëshme (3+2+3) në bashkëveprim me partnerin strategjik;

   b. nxitë punën shkencore-kerkimore të kuadrit mësimdhënës të Kolegjit Universitar "Universum";

   c. përcjellë pervojën e stafit të ASAU-së në zhvillimin e programeve të avansuara të studimit në gjuhën angleze në studimet themelore të Kolegjit Universitar "Universum";

   d. stimulon studentët për përpjekje shtesë në mësimin e gjuhës angleze gjatë studimeve themelore;

   e. lehtëson njohjen ndërkombëtare të shkallës themelore akademike të fituar gjatë studimeve në gjuhën shqipe dhe transferin e krediteve të fituara në këtë program në universitetet jasht vendit, dhe kështu ndikon pozitivisht në mundësinë e regjistrimit të studentëve të diplomuar në studimet themelore në Kolegjin Universitar "Universum" në studimet postdiplomike në universitetet me renome ndërkombëtare;

   f. mundëson shfrytzimin e një fondi të librave, revistave shkencore dhe softverit të ASAU-së për studentët e studimeve themelore të Kolegjit Universitar "Universum";

   g. nëpermjet të interakcionit të studentëve nga studimet themelore me studentët në studimet e avansuara, ngritë motivimin e studentëve të rinjë të regjistruar në programet e studimeve themelore të Kolegjit Universitar "Universum" për punë shkencore-kërkimore;

   h. racionalizon shfrytzimin e resurseve ekzistuese të Kolegjit Universitar "Universum" duke zgjatur kohën e shfrytzimit të tyre ne orët e mbrëmjes dhe ditëve të fundjavës, dhe duke përcjellë një pjesë të shpenzimeve te ASAU-ja ulë koston e studimeve për një student;

   i. për shkak të bashkëverpimit të aktiviteteve, perfiton nga efektet indirekte që prodhon reklama dhe publiciteti i programeve të ASAU-së;

j. ndihmon Kolegjin Universitar "Universum" të akreditojë programet themelore të tija nga ana e agjencive ndërkombëtare me reputacion, si rezultat i prezences së programeve të avansuara të studimeve të ASAU-së, dhe kështu do të mundësojë punësimin e studentëve jashtë vendit.

7. Ofrimi i programeve të avansuara në gjuhen angleze në bashkëpunim strategjik me Kolegjin Universitar "Universum" do të sjelli këto përparsi për ASAU-në:

   a. për shkak të numrit shumë të kufizuar të studentëve në programet e studimeve posdiplomike dhe doktoratës (gjithsej rreth 20 veta), kostoja margjinale e shfrytzimit të resurseve të Kolegjit Universitar "Universum" do të jetë shumë më e ultë se sa zhvillimi dhe mbajtja e infrasturkturës së pavarur (sallave të mësimit, bibliotekës, teknologjisë informatike, sekretarisë, mirëmbajtjes dhe ruajtjes së objektit etj);

   b. një numri i konsiderueshëm asistentësh nga Kolegji Universitar "Universum" do të mund të ndiqnin mësimet në programin master dhe të doktoratës të ASAU-së, dhe si rezultat i përparësive të punës dhe studimit në një vend, ata do të stimuloheshin që të punojnë dhe të studjojnë me përkushtim të shtuar;

   c. shfrytzimi i objektit dhe tekonologjisë së Kolegjit Universitar "Universum" lehtëson punën e ASAU-së në administrimit të programit dhe do të thjeshtësonte procesin e komplikuar të marrjes së licencës për punë dhe akreditimit të programit nga ana e agjencive me reputacion ndërkombëtar.

8. Si dëshmi e vullnetit të mirë për bashkëpunim strategjik me leverdi reciproke, secili partner ofron partnerit tjeter beneficione të caktuara, shprehimisht:

   a. ASAU-ja e përkrahë Kolegjin Universitar "Universum" me tërë potencialin e vet kadrovik gjatë aplikimit për licencim te MASHT-i dhe ofron mbështetje për akreditimin e programeve të afërta me ekspertizën dhe reputacionin e vet;

   b. Kolegji Universitar "Universum" do t'u lejë ASAU-së në shfrytzim një zyrë, qasje pedagogëve dhe studentëve të ASAU-së të shfrytzojë një pjesë të infrastrukturës, dhe do të huazoj një sallë për mësimdhënie me 20 ulëse pas orarit zyrtar të punës (nga ora 17 deri 20) dhe gjatë tërë ditës së shtunë me një qira prej (30 eruo në muaj, e cila rrjedh nga dita e parë e punës deri në ditën kur ASAU-ja përfundon partneritetin strategjik me Kolegjin Universitar "Universum".

   c. Për secilin shërbim shtesë mbi atë të specifikuar në nënparagrafin e sipërm që e shfrytzon ASAU-së, ajo to të paguaj Kolegjit Universitar "Universum" kompenzimin për këtë infrastrukturë sipas marëveshjes paraprake të vlerësuar në bazë të shpenzimeve mesatare të infrastrukturës së shfrytzuar.

   d. ASAU-ja do të furnizojë bibliotekën ekzistuese të Kolegjit Universitar "Universum" me literaturë nga fusha e programeve që do të ofrojë.

   e. ASAU-ja do të instalojë në kompjutorët e Kolegjit Universitar "Universum" softverin e nevojshëm për punë kërkimore, të cilin do të mund të shfrytëzojnë të gjithë studentët dhe stafi i Kolegjit Universitar "Universum".

   f. ASAU-ja do të paguaj Kolegjin Universitar "Universum" për çdo angazhim shtesë të përsonelit sipas kërkesës, dhe anasjelltas.

g. Tarifat për rimbursimin e shpenziveve sipas nënparagrafeve (të sipërpërmendura) 8.c deri 8.f do të jenë pjesë e Kontratës për Bashkëpunim Strategjik.

h. Kolegji Universitar "Universum" do të bëjë faturimin e shpenzimeve të shkaktuara nga sherbimet e ofruara nga ASAU-ja për çdo muaj në fillim të muajit vijues.

i. ASAU-ja do të paguaj faturat në afat prej 15 ditesh nga dita e pranimit të tyre në formë të tranferit elektronik në llogarinë bankare të Kolegjit Universitar "Universum".

9. **E drejta intelektuale, licenca e punës dhe akreditimi i programeve**

a. Programet mësimore, materiali për studim, ushtrimoret, softveri i zhvilluar dhe të gjitha produktet tjera mbesin pronësi intelektuale e partnerit që ka blerë ose zhvilluar ato. Përdorimi sado i gjatë edhe në çfardo mënyre i këtyre produkteve nga partneri tjeter, i cili nuk i ka blerë ose zhvilluar këto produkte, nuk japin bazë për të drejtë intelektuale mbi to, perveç në rast se me marrëveshje ose me kontratë të veçantë këto çështje rregullohen ndryshe.

b. Përkundër ndihmës reciproke që partnërët japin njeri tjetrit, secili partner është përgjegjës për licencim, akreditim dhe menaxhim të programeve që i ofron, dhe ato nuk mund të barten në partnerin tjetër e as të prodhojnë kurëfare obligimesh mbi partnerin tjetër pa një marëveshje paraprake midis partnerëve strategjik.

c. Pushimi i licencës për një program apo të gjitha programet e njërit partner, si dhe pushimi i veprimtarisë së njërit partner, nuk mund të prodhojë kurëfarë pasojash të drejtpërdrejta për licencën apo licencat e partnerit tjetër dhe ky Memorandum konsiderohet inekzistent.

10. Të dy partnerët bien në ujdi që vazhdimisht të bëjnë përpjekje maksimale për menaxhimin, zhvillimin dhe për avancimin e programeve komplementare:

a. Kolegji Universitar "Universum" do të përqëndrohet në zhvillimin dhe zgjërimin e mëtejshem të infrastrukturës dhe bazës kadrovike për studime themelore në gjuhen shqipe, por pa heqë dorë nga programi për Master kur të diplomojë gjenerata e parë e studentëve në studime themelore.

b. ASAU-ja përqëndrohet në avancimin e punës kërkimore-shkencore dhe zhvillimin e programeve të avansuara (master dhe doktoratë) me mësim ne gjuhën angleze.

Ky Memorandum Bashkëpunimi është obligues për palët e poshtënënshkruara: Kontrata për bashkëpunim strategjk është pjesë përbërëse e këtij Memorandumi dhe forca e tij nuk pushon as në momentin e nënshkrimit të kontratës për bashkëpunim strategjik.

z. Suat Berisha, Président
Kolegji Universitar "Universum"

Prof. dr. Nexhmi Rexha, Dekan
Akademia për studime të avansura universitare

MEMORANDUM MIRËKUPTMI

i lidhur në Prishtinë me datën 3 qershor 2005 midis partnerëve strategjik:

Kolegjit universitar "Universum" me seli në Prishtinë, Lagja Veterrniku, p.n., përfaqsuar nga Presidenti z. Suat Berisha

dhe

Akademisë për studime të avansuara universitare me seli në Prishtinë, Rruga "24 Maji", (ish "N. Hikmet") nr. 15, përfaqësuar nga Dekani is sajë prof. dr. Nexhmi Rexha.

Kolegji Universitar "Universum" dhe Akademia për studime të avansuara universitare (këtu e tutje referuar si ASAU), kanë ra në ujdi të veprojnë si partnerë strategjik. Qëllimi kryesor i bashkëpunimit midis këtyre dy partnerëve strategjik është shfrytzimi sinergjik i aftësive (kompetencave) ekzistuese në bashkërenditjen e aktiviteteve në zhvillimin e programeve bashkëkohore arsimore universitare që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve të studimeve në nivel botëror në të dyja subjektet. Partnerët strategjik planifikojnë aktivitete që e plotësojnë por nuk e konkurrojnë njëri tjetrin. Ky akt ka për qëllim që të dokumentojë vendosmërinë dhe përkushtimin e partnerëve strategjik për të ndihmuar njeri tjetrin të ndërtojnë kapacitete pedagogjike dhe kërkimore që janë komplementare dhe shfrytzohen në dobi të ngritjes së aftësive mësimëdhënëse dhe kërkimore të dy partnerëve.

Partnerët janë të bindur që bashkërenditja e aktiviteteve të tyre mund të krijojë sinergji për këto arsye:

1. Kolegji Universitar "Universum" ka krijuar përvojë shumë të vlefshme në organizimin e mësimdhënies parauniversitare nëpërmjet parardhësit e tijë Kolegjit "Aga Xhite", dhe gëzon reputacion për integritet akademik në mbarë Kosovën.

2. ASAU është themeluar nga Qendra Kosovare për Marketing dhe Menaxhim (QKEMM) në maj të vitit 2005. QKEMM-i është aktiv në fushën e kërkimeve, trajnimeve dhe botimeve profesionale e shkencore që nga janari i vitit 2000. Që prej atëherë është angazhuar në organizimin dhe mbajtjen e seminareve për stafin ekzekutiv dhe pesonelit kerkimor në ndërmarrjet dhe institucionet kosovare, ka botuar Fjalorin angisht-shqip dhe shqip-anglisht të biznesit, i pari dhe edhe sot i vetmi i këtij lloji; themeluesi i tij ka përvojë të gjatë në mësimdhënie në studimet postdiplomike dhe udheheqje akademike të doktorantëve në universitetet me renome ndërkombëtare në Evropë, Australi, Azi dhe SHBA, ka botuar një numër të madh artikujsh shkencorë në revistat shkencore ndërkombëtare me reputacion (ShBA) në gjuhen angleze, ka kontribuar substancialisht në fillimin e Programit Master në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë, dhe gëzon reputacion të pakontestushem shkencor në vend dhe jashtë vendit.

3. Ekziston një numër i vogël, por në rritje, i kandidatëve të cilët do të mund të ndjekin mësimet në gjuhen angleze në programin master dhe të doktoratës, kurse mësimi ne gjuhen agleze është esencial për transferin e krediteve në frymen e Deklaratës së Bolonjës për hapsirën unike evropiane të arsmit të lartë.

4. Ofrimi i programeve të avansuara postdiplomike për master dhe doktoratë nga ana e ASAU-së në ambientet e Kolegjit Universitar "Universum" do t'u ofrojnë asistentëve të

këtij Kolegji mundësinë që dretjtpërejti t'i aplikojnë njohuritë e tyre të fituara në studime në procesin pedagogjik gjatë punës së tyre me studentët në studimet themelore.

5. Me bashkëpunimin strategjik, të dy partnerët strategjik do të vejnë efektivisht në shërbim të njëri tjetrit resurset materiale e kadrovike, pervojen në menaxhim të mësimdhënies dhe udhëheqjes shkencore të studentëve, si dhe të organizimit të punës kërkimore-shkencore e botuese.

6. Ky bashkëpunim sjell efekte shumë positive për Kolegjin Universitar "Universum", shprehimisht bashëpunimi:

   a. ndihmon ngritjen e mëtejme të reputacionit të Kolegjit Universitar "Universum" si rezultat i kompletimit të hershëm të programeve të avansuara të studimeve për master dhe doktoratë nëpërmjet të partnerit strategjik, d.m.th. afirmon programet e studimeve themelore që planifikon të ofrojë Kolegji, duke kompletuar ato me të gjitha programet studimore të mundëshme (3+2+3) në bashkëveprim me partnerin strategjik;

   b. nxitë punën shkencore-kerkimore të kuadrit mësimdhënës të Kolegjit Universitar "Universum";

   c. përcjellë pervojën e stafit të ASAU-së në zhvillimin e programeve të avansuara të studimit në gjuhën angleze në studimet themelore të Kolegjit Universitar "Universum";

   d. stimulon studentët për përpjekje shtesë në mësimin e gjuhës angleze gjatë studimeve themelore;

   e. lehtëson njohjen ndërkombëtare të shkallës themelore akademike të fituar gjatë studimeve në gjuhën shqipe dhe transferin e krediteve të fituara në këtë program në universitetet jasht vendit, dhe kështu ndikon pozitivisht në mundësinë e regjistrimit të studentëve të diplomuar në studimet themelore në Kolegjin Universitar "Universum" në studimet postdiplomike në universitetet me renome ndërkombëtare;

   f. mundëson shfrytzimin e një fondi të librave, revistave shkencore dhe softverit të ASAU-së për studentët e studimeve themelore të Kolegjit Universitar "Universum";

   g. nëpermjet të interakcionit të studentëve nga studimet themelore me studentët në studimet e avansuara, ngritë motivimin e studentëve të rinjë të regjistruar në programet e studimeve themelore të Kolegjit Universitar "Universum" për punë shkencore-kërkimore;

   h. racionalizon shfrytzimin e resurseve ekzistuese të Kolegjit Universitar "Universum" duke zgjatur kohën e shfrytzimit të tyre ne orët e mbrëmjes dhe ditëve të fundjavës, dhe duke përcjellë një pjesë të shpenzimeve te ASAU-ja ulë koston e studimeve për një student;

   i. për shkak të bashkëverpimit të aktiviteteve, perfiton nga efektet indirekte që prodhon reklama dhe publiciteti i programeve të ASAU-së;

j. ndihmon Kolegjin Universitar "Universum" të akreditojë programet themelore të tija nga ana e agjencive ndërkombëtare me reputacion, si rezultat i prezences së programeve të avansuara të studimeve të ASAU-së, dhe kështu do të mundësojë punësimin e studentëve jashtë vendit.

7. Ofrimi i programeve të avansuara në gjuhen angleze në bashkëpunim strategjik me Kolegjin Universitar "Universum" do të sjelli këto përparsi për ASAU-në:

   a. për shkak të numrit shumë të kufizuar të studentëve në programet e studimeve posdiplomike dhe doktoratës (gjithsej rreth 20 veta), kostoja margjinale e shfrytzimit të resurseve të Kolegjit Universitar "Universum" do të jetë shumë më e ultë se sa zhvillimi dhe mbajtja e infrasturkturës së pavarur (sallave të mësimit, bibliotekës, teknologjisë informatike, sekretarisë, mirëmbajtjes dhe ruajtjes së objektit etj);

   b. një numri i konsiderueshëm asistentësh nga Kolegji Universitar "Universum" do të mund të ndiqnin mësimet në programin master dhe të doktoratës të ASAU-së, dhe si rezultat i përparësive të punës dhe studimit në një vend, ata do të stimuloheshin që të punojnë dhe të studjojnë me përkushtim të shtuar;

   c. shfrytzimi i objektit dhe tekonologjisë së Kolegjit Universitar "Universum" lehtëson punën e ASAU-së në administrimit të programit dhe do të thjeshtësonte procesin e komplikuar të marrjes së licencës për punë dhe akreditimit të programit nga ana e agjencive me reputacion ndërkombëtar.

8. Si dëshmi e vullnetit të mirë për bashkëpunim strategjik me leverdi reciproke, secili partner ofron partnerit tjeter beneficione të caktuara, shprehimisht:

   a. ASAU-ja e përkrahë Kolegjin Universitar "Universum" me tërë potencialin e vet kadrovik gjatë aplikimit për licencim te MASHT-i dhe ofron mbështetje për akreditimin e programeve të afërta me ekspertizën dhe reputacionin e vet;

   b. Kolegji Universitar "Universum" do t'u lejë ASAU-së në shfrytzim një zyrë, qasje pedagogëve dhe studentëve të ASAU-së të shfrytzojë një pjesë të infrastrukturës, dhe do të huazoj një sallë për mësimdhënie me 20 ulëse pas orarit zyrtar të punës (nga ora 17 deri 20) dhe gjatë tërë ditës së shtunë me një qira prej (30 eruo në muaj, e cila rrjedh nga dita e parë e punës deri në ditën kur ASAU-ja përfundon partneritetin strategjik me Kolegjin Universitar "Universum".

   c. Për secilin shërbim shtesë mbi atë të specifikuar në nënparagrafin e sipërm që e shfrytzon ASAU-së, ajo to të paguaj Kolegjit Universitar "Universum" kompenzimin për këtë infrastrukturë sipas marëveshjes paraprake të vlerësuar në bazë të shpenzimeve mesatare të infrastrukturës së shfrytzuar.

   d. ASAU-ja do të furnizojë bibliotekën ekzistuese të Kolegjit Universitar "Universum" me literaturë nga fusha e programeve që do të ofrojë.

   e. ASAU-ja do të instalojë në kompjutorët e Kolegjit Universitar "Universum" softverin e nevojshëm për punë kërkimore, të cilin do të mund të shfrytëzojnë të gjithë studentët dhe stafi i Kolegjit Universitar "Universum".

   f. ASAU-ja do të paguaj Kolegjin Universitar "Universum" për çdo angazhim shtesë të përsonelit sipas kërkesës, dhe anasjelltas.

g. Tarifat për rimbursimin e shpenziveve sipas nënparagrafeve (të sipërpërmendura) 8.c deri 8.f do të jenë pjesë e Kontratës për Bashkëpunim Strategjik.

h. Kolegji Universitar "Universum" do të bëjë faturimin e shpenzimeve të shkaktuara nga sherbimet e ofruara nga ASAU-ja për çdo muaj në fillim të muajit vijues.

i. ASAU-ja do të paguaj faturat në afat prej 15 ditesh nga dita e pranimit të tyre në formë të tranferit elektronik në llogarinë bankare të Kolegjit Universitar "Universum".

9. **E drejta intelektuale, licenca e punës dhe akreditimi i programeve**

a. Programet mësimore, materiali për studim, ushtrimoret, softveri i zhvilluar dhe të gjitha produktet tjera mbesin pronësi intelektuale e partnerit që ka blerë ose zhvilluar ato. Përdorimi sado i gjatë edhe në çfardo mënyre i këtyre produkteve nga partneri tjeter, i cili nuk i ka blerë ose zhvilluar këto produkte, nuk japin bazë për të drejtë intelektuale mbi to, perveç në rast se me marrëveshje ose me kontratë të veçantë këto çështje rregullohen ndryshe.

b. Përkundër ndihmës reciproke që partnërët japin njeri tjetrit, secili partner është përgjegjës për licencim, akreditim dhe menaxhim të programeve që i ofron, dhe ato nuk mund të barten në partnerin tjetër e as të prodhojnë kurëfare obligimesh mbi partnerin tjetër pa një marëveshje paraprake midis partnerëve strategjik.

c. Pushimi i licencës për një program apo të gjitha programet e njërit partner, si dhe pushimi i veprimtarisë së njërit partner, nuk mund të prodhojë kurëfarë pasojash të drejtpërdrejta për licencën apo licencat e partnerit tjetër dhe ky Memorandum konsiderohet inekzistent.

10. Të dy partnerët bien në ujdi që vazhdimisht të bëjnë përpjekje maksimale për menaxhimin, zhvillimin dhe për avancimin e programeve komplementare:

a. Kolegji Universitar "Universum" do të përqëndrohet në zhvillimin dhe zgjërimin e mëtejshem të infrastrukturës dhe bazës kadrovike për studime themelore në gjuhen shqipe, por pa heqë dorë nga programi për Master kur të diplomojë gjenerata e parë e studentëve në studime themelore.

b. ASAU-ja përqëndrohet në avancimin e punës kërkimore-shkencore dhe zhvillimin e programeve të avansuara (master dhe doktoratë) me mësim ne gjuhën angleze.

Ky Memorandum Bashkëpunimi është obligues për palët e poshtënënshkruara: Kontrata për bashkëpunim strategjk është pjesë përbërëse e këtij Memorandumi dhe forca e tij nuk pushon as në momentin e nënshkrimit të kontratës për bashkëpunim strategjik.

z. Suat Berisha, Président
Kolegji Universitar "Universum"

Prof. dr. Nexhmi Rexha, Dekan
Akademia për studime të avansura universitare

KOLEGJI UNIVERSUM

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

midis

Kolegjit ''UNIVERSUM''- Prishtinë

dhe

New Age School

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Me anë të këtij memorandumi, Kolegji Universum merr përsipër ofrimin e bursave të pjesshme akademike për **punonjësit dhe nxënësit** e organizatës së lartpërmendur.
2. Bursat ofrohen për nivelin Baçelor dhe Master, dhe janë të aplikueshme për të gjitha programet e akredituara të Kolegjit Universum.
3. Përmes këtij memorandumi, Kolegji Universum merr përsipër ofrimin e zbritjes në cmimin e certifikimit ndërkombëtar Anglia Academy, për stafin dhe nxënësit e ogranizatës së lartëpërmendur.
4. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit New Age School do ti mundësojë studentëve të Kolegjit Universum përfundimin e internshipit/punës praktike me kohëzgjatje të dakorduar në mes të Kolegjit Universum dhe organizatës së lartpërmendur.
5. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, palët dakordohen që të bëjnë shkëmbimin e stafit **(në raste të caktuara)** për pjesëmarrje në ligjërata publike apo evenimente të organizuara në frymën profesionale.

III. Përzgjedhja e Kandidatëve për Bursa

Përzgjedhja e përfituesve të bursave do të bëhet nga New Age School duke respektuar kriteret e përgjithshme. Përvoja paraprake dhe mundësia e kandidatëve për tu ngritur në karrierë duhet të merren parasysh gjatë procesit të përzgjedhjes. Preferohet që përzgjedhja e kandidatëve të mos koncentrohet në një departament apo nivel të menaxhmentit. Preferohet që të ketë diversitet (gjinor, etnik, fetar dhe social) gjatë përzgjedhjes së kandidatëve.

IV. Përzgjedhja e Kandidatëve për Internship/Punë Praktike

1. Përzgjedhja e Kandidatëve për Internship/Punë Praktike do të bëhet nga Kolegji Universum duke marrë parasysh nevojat dhe konkurset e New Age School.

2. Kolegji Universum do të sigurojë që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre profesionale.

V. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

I. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëres palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

II. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë;

VI. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

VII. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Prishtinë, më /Janar/2018

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji ''UNIVERSUM''
Alejtin Berisha
Drejtor Ekzekutiv

KOLEGJI UNIVERSUM * UNIVERSUM * PRISHTINË

Përfaqësuar nga:

New Age School Prishtinë



KOSOVA

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet

4-H Kosova, Organizate jo-qeveritare (OJQ) me numer regjistrimi 5116806-2, e regjistruar ne Kosove, ne pajtim me ligjet e Kosoves, me adresen "Rruga B – Mati 1 (Labi Invest III/23), Prishtine, perfaqesuar nga Clirim Sheremeti, Drejtor Ekzekutiv, me tutje referuar si "4-H Kosova"

dhe

Kolegji Universum, me zyre kryesore ne Prishtine, rr. "Imzot Nikprela" p.n., perfaqesuar nga Alejtin Berisha, Drejtor Ekzekutiv, me tutje referuar si "Kolegji Universum".

Prapavija

Ky dokument përshkruan bashkëpunimin ndërmjet OJQ '4-H Kosova' dhe Kolegji Universum në fushën e edukimit jo-formal ndërmjet klubeve shkollore.

Keto pale zotohen:

Neni 1
Objektivat

1.1 Të sigurojnë një bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet OJQ '4-H Kosova' dhe Kolegji Universum
1.2 Të zhvillojnë edukimin dhe arsimin jashtë-mësimor, përmes projekteve dhe aktiviteteve që bazohen në të mësuarit praktik, konkretisht me metodën 'Learning By Doing'
1.3 Te fuqizohen dhe aftesohen studentet e Kolegji Universum dhe anetaret e klubeve 4-H Kosova ne fusha si lidershipi, komunikimi, puna ne ekip, he fusha tjera, varesisht nga natyra e klubit
1.4 Te promovohen vlera si: mendimi I lire, mendimi kritik, qytetaria aktive, aftesia per ndryshim etj.
1.5 Te pajise vullnetaret studente te Kolegji Universum ne fund te sherbimit te tyre me nje certifikate te nenshkruar nga te dyja palet, ku njihet puna dhe kontributi I tyre.

Neni 2
Pergjegjesite e 4-H Kosova

2.1 Trajnimi i studenteve te Kolegji Universum te interesuar per te qene lidere vullnetare ne klubet e

4-H KOSOVA Kosova Prishtinë

KOLEGJI UNIVERSUM UNIVERSUM PRISHTINË

4-H Kosova, nga 4-H Kosova

2.2 Perkrahja e ketyre studenteve ne hapjen dhe menaxhimin e klubeve me resurse, mjete, keshillim, dhe cfaredo forme tjeter te mundshme

2.3 Ofrimi I mundesive per zhvillim profesional te ketyre studenteve si brenda, ashtu dhe jashte organizates, ndermjet trajnimeve, ligjeratave, etj. brenda mundesive te 4-H Kosova

Neni 3

Pergjegjesite e Kolegji Universum

3.1 Informimi dhe perkrahja e studenteve te cilet mund te jene te interesuar te jene lidere vullnetare per klubet e 4-H Kosova dhe te kontribuojne ne organizate.

3.2 Perkrahja teknike dhe profesionale e 4-H Kosova, brenda mundesive te Kolegji Universum, veçanerisht kur eshte fjala tek aktivitetet e lidereve vullnetare studente te Kolegji Universum.

Neni 4

Pergjegjesite e perbashketa

4.1 Paisja e studenteve te Kolegji Universum me certifikate per njohje te punes vullnetare, e nenshkruar ng ate dyja palet.

4.2 Koha minimale e punes vullnetare e nevojshme per paisje me certifikate eshte 100 ore.

Neni 5

Afati i zbatimit

4.1 Kjo marreveshje ka nje kohezgjatje fillestare prej dy viteve dhe hyn ne fuqi ne daten e nenshkruar. Me pelqimin e paleve, marreveshja ka mundesi vazhdimi.

4.2 Marreveshja mund te nderpritet me kerkesen e njeres pale, te parashtruar 30 dite me heret.

Neni 5

Plotesimet dhe ndryshimet

5.1 Marreveshja mund te plotesohet apo ndryshohet me pelqimin e te dyja paleve.

5.2 Cdo plotesim apo ndryshim behet me shkrim dhe eshte pjese e kesaj marreveshje.

Çlirim Spahiu
Drejtor Ekzekutiv
OJQ "4-H Kosova"

Mejtë Berisha
Drejtor Ekzekutiv
Kolegji Universum

KOLEGJI UNIVERSITAR
UNIVERSUM
PRISHTINË
Nr. 265/1 dt. 12.10.2007

UNIVERSUM
University College

AKB
Aleanca Kosovare e Bizneseve
Alliance of Kosovar Businesses

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NË MES TË

1. UNIVERSITETIT " UNIVERSUM"- PRISHTINË
2. ALEANCA KOSOVARE E BIZNESEVE

Për bashkëpunimin dhe njohje të ndërsjella

I . Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Me këtë Memorandum palët nënshkruese kanë shprehë vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjella, me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të mëtejmë të njohurive profesionale dhe akademike, si dhe me qëllim të ndërlidhjes së mësimit akademik me punën praktike dhe anasjelltas;

2. Realizimi i këtij qëllimi do të arrihej përmes përcaktimit të një plani të dinamikës së veprimit i cili do të harmonizohej paraprakisht nga të dyja palët dhe si i tillë do të ishte pjesë përbërëse e këtij Memorandumi;

II. Fushëveprimtaria

Bashkëpunimi i ndërsjellë i palëve do të realizohej në këto fusha veprimi:

1. Qasja e studenteve dhe stafit akademik të Universitetit UNIVERSUM në ambientet e Aleancës Kosovare të Bizneseve me qëllim të realizimit të mësimit praktik nga fushat e caktuara;

2. Mbështetja dhe evoluimi i studenteve nga ana e stafit menaxherial të Aleancës Kosovare të Bizneseve në kuptimin e njohjes praktike me strukturën organizative Aleancës Kosovare të Bizneseve;

3. Qasja e studenteve dhe stafit akademik në projektet kërkimore hulumtuese nga fushëveprimtaria e Aleancës Kosovare të Biznesëve; Angazhim i stafit akademik të Universitetit UNIVERSUM në avancimin profesional të stafit menaxherial të Aleancës Kosovare të Biznesëve përmes trajnimeve profesionale;

1. Angazhimi i studenteve të Universitetit UNIVERSUM në grumbullimin, hulumtimin dhe sistemimin e të dhënave për nevoja dhe sipas kërkesave të stafit drejtues të Aleancës Kosovare të Biznesëve;

2. Pjesëmarrja e kohëpaskohshme e eksperteve profesional të Aleancës Kosovare të Biznesëve në ligjërata nga fushat profesionale para studenteve të Universitetit UNIVERSUM;

3. Pjesëmarrja e stafit menaxhues në trajnime profesionale të cilat i organizon Universitetit UNIVERSUM;

4. Universitetit UNIVERSUM dhe Aleanca Kosovare e Biznesëve (AKB) në Prishtinë pajtohen që në përgatitjen e propozimeve dhe realizimin e projekteve të përbashkëta, që kanë të bëjnë me përmirësimin e ambientit ekonomik dhe social në Kosovë, hartimin e analizave ekonomike, në mënyrë të rregullt të paraqesin ofertën e përbashkët dhe të këmbejnë informata të domosdoshme për implementimin e projekteve;

5. Varësisht nga sigurimi i fondeve nga të dyja palët, do të mundësohet vazhdimi i studimeve të mëtejme të stafit menaxhues në Universitetin UNIVERSUM pa shkëputje nga puna.

III Përdorimi i informatave dhe dokumentacionit

1. Palët janë pajtuar se çdo informatë, e dhënë dhe dokument i shkëmbyer ose pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit do të përdoret vetëm për qëllime të lejuara dhe përbrenda përkufizimeve të përcaktuar me të njëjtin.
   Palët nuk do të shpërndajnë apo të bëjnë publike asnjë informatë, të dhënë ose dokument të ndonjërës palë për qëllime të kundërta të Memorandum Mirëkuptimit pa aprovimin paraprak të palës tjetër, përpos në raste kur çdo informatë, e dhënë ose dokument i njërës ose palës tjetër është i destinuar për përdorim publik.

2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informatë, të dhënë ose dokument si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë.

IV. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim ose keqinterpretim në realizimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

V. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga an e palëve kontraktuese.

Prishtinë, me 02.10.2007.

Universiteti "UNIVERSUM"
Rektori,
Prof. Dr. Musa Limani

Aleanca Kosovare e Biznesëve
Kryetari,
Agim Shehmi

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Në mes të

KOLEGJI "UNIVERSUM"
Prishtinë, Lagja Ulpiana p. n.

Dhe

INSTITUTI PER STUDIME TE AVANCUARA GAP
Prishtinë, Rr. Nëna Terezë, Nr. 41/29

Për bashkëpunimin dhe njohje të ndërsjella

I

Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Me këtë Memorandum palët nënshkruese kanë shprehë vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjella, me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të mëtejmë të njohurive profesionale dhe akademike, si dhe me qëllim të ndërlidhjes së mësimit akademik me punën praktike dhe anasjelltas;
2. Realizimi i këtij qëllimi do të arrihej përmes përcaktimit të një plani të dinamikës së veprimit i cili do të harmonizohej paraprakisht nga të dyja palët dhe si i tillë do të ishte pjesë përbërëse e këtij Memorandumi;

II

Fushë-veprimtaria

Bashkëpunimi i ndërsjellë i palëve do të realizohej në këto fusha veprimi:

1. Qasja e studenteve dhe stafit akademik të Kolegjit UNIVERSUM në ambientet e Institutit për Studime të Avancuara GAP me qëllim të realizimit të mësimit praktik nga fushat e caktuara;

2. Mbështetja dhe evaluimi i studenteve nga ana e stafit menaxherial të Institutit për Studime të Avancuara GAP në kuptimin e njohjes praktike me strukturën organizative të Institutit për Studime të Avancuara GAP;
   Qasja e studenteve dhe stafit akademik në projektet kërkimore hulumtuese nga fushë-veprimtaria e Institutit për Studime të Avancuara GAP;

3. Angazhim, i stafit akademik të Kolegjit UNIVERSUM në avancimin profesional të stafit menaxherial të Institutit për Studime të Avancuara GAP përmes trajnimeve profesionale;

4. Angazhimi i studenteve të Kolegjit UNIVERSUM në grumbullimin, hulumtimin dhe sistemimin e të dhënave për nevoja dhe sipas kërkesave të stafit drejtues të Institutit për Studime të Avancuara GAP;

5. Pjesëmarrja e kohëpaskohshme e eksperteve profesional të Institutit për Studime të Avancuara GAP në ligjërata nga fushat profesionale para studenteve të Kolegjit UNIVERSUM;

6. Pjesëmarrja e stafit menaxherial në trajnime profesionale të cilat i organizon Kolegji UNIVERSUM;

7. Angazhimi i dyanshëm me projekte tjera dhe fusha tjera të cilat nuk janë përfshirë në këtë Memorandum;

8. Varësisht nga sigurimi i fondeve nga të dyja palët, do të mundësohet vazhdimi i studimeve të mëtejme të stafit menaxhues në Kolegjin UNIVERSUM pa shkëputje nga puna.

III Përdorimi i informatave dhe dokumentacionit

1. Palët janë pajtuar se çdo informacion, e dhënë dhe dokument i shkëmbyer ose pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit do të përdoret vetëm për qëllime të lejuara dhe përbrenda përkufizimeve të përcaktuar në Memorandumin e Mirëkuptimit.
   Palët nuk do të shpërndaj apo të bëje publike asnjë informacion, të dhënë ose dokument të ndonjërës palës për qëllime të kundërta të Memorandum Mirëkuptimit pa aprovimin paraprak të palës tjetër, përpos në raste kur çdo informatë, e dhënë ose dokument i njërës ose palës tjetër është i destinuar për përdorim publik.
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informatë, të dhënë ose dokument si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë.

IV **Dispozita Përfundimtare**

1. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim ose keqinterpretim në realizimin e këtij Memorandumit do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

2. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga an e palëve kontraktuese.

3. Ky Memorandum është përpiluar në katër kopje identike, ku secila palë merr nga dy kopje identike.

Prishtinë, më

19.04.2011

Palët nënshkruese

KOLEGJI "UNIVERSUM"

DREJTORI EKZEKUTIV

Alejtin Berisha, MA

INSTITUTI GAP

DREJTOR EKYEKUTIV

Agron Demi

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo Finasija – Ministry of Finance

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

MINISTRISË SË FINANCAVE

dhe

1. KOLEGJIT "AAB" PRISHTINË
2. KOLEGJIT "UNIVERSUM" PRISHTINË
3. KOLEGJIT "DARDANIA" PRISHTINË
4. KOLEGJIT "PJETËR BUDI" PRISHTINË.

për angazhimin e studentëve punë praktike

Prishtinë, 29.03.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arkiva - Archive
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit 01
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No. 829-1
Klasifikimi / Brojčanik / Kod. 7
Data / Datum / Date 27/04/2016
PRISHTINË/A

Bazuar në nevojat për të përgatitë studentët për tregun e punës në fushat që lidhen me Ministrinë e Financave dhe agjencitë e saj, dhe në Thirrjen për shprehje interesi për bashkëpunim me universitetet dhe kolegjet private lidhur me angazhimin e studentëve në punë praktike, shpallur nga Ministria e Financave me datë 8.03.2016, palët pajtohen si në vijim:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi të bashkëpunimit është promovimi i aftësimit profesional të studentëve të Kolegjeve palë të memorandumit, në fushat që lidhet me Ministrinë e Financave dhe agjencitë e saj.

Neni 2
Fushëveprimi

Ky memorandum rregullon formën e bashkëpunimit të Ministrisë së Financave në njërën anë, dhe Kolegjeve të cekura më lart, në anën tjetër, lidhur me angazhimin e studenteve në punë praktike në Ministrinë e Financave dhe agjencitë e saj.

Neni 3
Kohëzgjatja e punës praktike

Puna praktike që studentët kryejnë në Ministrinë e Financave dhe agjencitë e saj zgjat tre muaj.

Neni 4
Obligimet e palëve

1. Ministria e Financave do të marrë në punë praktike nga 20 studentë për çdo tre muaj (apo 80 studentë në vit) nga këto institucione të arsimit të lartë:
   i). Kolegji "AAB" - 5 studentë çdo tre muaj,
   ii). Kolegji ""Universum" - 5 studentë çdo tre muaj,
   iii). Kolegji "Dardania" - 5 studentë çdo tre muaj,
   iv). Kolegji "Pjetër Budi" - 5 studentë çdo tre muaj.
2. Nga numri i përgjithshëm i studentëve që do ta kryejnë praktikën në baza tremujore, drejtimet e pranuara do të jenë: të ekonomisë (të gjitha drejtime), juridik dhe shkenca kompjuterike.
3. Kolegjet palë të këtij memorandumi, e bëjnë përzgjedhjen e studentëve dhe i ofrojnë Ministrisë së Financave listën e përzgjedhur të studentëve çdo tre muaj.

Neni 5
Kriteret për përzgjedhjen e studenteve për punë praktike

1. Në përzgjedhjen e studentëve për punë praktike, Kolegjet palë në këtë Memorandum, do të marrin parasysh notën mesatare të studentëve.
2. Studentët që përzgjidhen për të kryer punë praktike duhet të kenë të kryer së paku vitin e dytë të studimeve bachelor ose të jenë te regjistruar në studimet master.

Neni 6

Rregullimi i punës praktike

1. Studentët e përzgjedhur për punë praktike duhet të nënshkruajnë kontratën e angazhimit me Ministrinë e Financave, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
2. Periudha e angazhimit ne pune praktikë zgjat tre muaj dhe është me pagesë, sipas mundësive buxhetore të Ministrisë së Financave.
3. Në fund të periudhës së angazhimit, Ministria e Financave bën vlerësimin e punës së praktikantëve dhe, bazuar në këtë vlerësim, lëshon certifikatë për punën praktike të kryer nga studentët.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me anë të konsultimeve ndemjet palëve.

Neni 8
Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët dhe vlen për kohë të pacaktuar.
2. Secila palë mundet kurdoherë të përfundojë këtë marrëveshje, me kusht që të njoftoj me shkrim palën tjetër së paku një muaj me herët.

Avdullah Hoti
Ministër i Financave

1. Lulzim Tafa
Rektor i Kolegjit " AAB" Prishtinë

2. Alejtin Berisha,
Drejtor Ekzekutiv i Kolegjit
"Universum" Prishtinë.

3. Gjyldane Mulla,
Rektore e Kolegjit "Dardania" Prishtinë.

4. Hashim Rexhepi,
Dekan i Kolegjit " Fjetër Budi" Prishtinë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Kolegji Universum

Në mbështetje të nenin 93 paragrafi 4, nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4, 21, 22 të Ligjit Nr.03/L-189 Për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 dhe Shtojcën 8 të Rregullores Nr.02/2011 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetje të NVM-ve dhe Kolegji Universum (KU) arrijnë këtë:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur me datën 15 Nëntor 2013 në mes të:

Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, e përfaqësuar nga Valdrin Lluka U.D Kryeshef i Agjencisë se NVM-ve, nga njëra anë; dhe

Kolegji Universum (KU), e përfaqësuar nga Alejtin Berisha, drejtor ekzekutiv –nga ana tjetër.

Neni 1
Qëllimi

1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Mbështetje të NVM-ve (në tekstin e mëtejmë AMNVM) në bashkëpunim me Kolegji Universum shpreh interesin e sinqert të të dyja palëve për implementimin e Monitorit Global të Ndërmarrësisë (Global Entrepreneurship Monitor), me shpresën dhe bindjen që ky projekt të ketë rëndësi të veçant në mirëqenjen e shoqërisë kosovare dhe lehtësimin e mëtejshëm të zhvillimi të ndërmarrësisë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë.

2. AMNVM dhe KU do të punojnë së bashku për arritjen e këtyre qëllimeve të projektit:
2.1. Të përfshijë Kosovën si shtet në Monitorin Global të Ndërmarrësisë
2.1. Të përpiloj Raportin Shtetëror të Kosovës, duke u bazuar në metodologjinë e Monitoritit Global të Ndërmarrësisë
2.3. Të kontribuoj në Monitorinin Global të Ndërmarrësisë duke i ofruar të dhëna për Kosovën
2.4. Të promovoj ndërmarrësinë dhe zhvillimin e NVM-ve në Kosovë, dukë ofruar të dhëna të besueshme dhe të dobishme për të gjitha grupet e interest (agjencitë qeveritare, donatorët, ndërmarrësit, qeverinë locale, etj)

Neni 2
Obligimet e palëve

1. Në mënyre që të arrihen qëllimet e projektit

2. KU do të jetë përgjegjës për:

2.1 Administrimin e raportit shtetëror të Kosovës për Monitorin Global të Ndërmarrësisë, duke përfshirë:
- 2.1.1 Sigurimin e të dhënave të kërkuara nga MGN-ja
- 2.1.2 Mbledhjen e Fokus Grupeve të Espertëve të kërkuar nga MGN-ja
- 2.1.3 Shkrimin e raportit të MGN-së për Kosovën

2.2 Kontribuimin në raportin global të MGN-së
2.3 Organizimin e konferencës vjetore të MGN-së në Kosovë
2.4 Shpërndarjen e Raportit të MGN-së për Kosovën tek audienca e kërkuar
2.5 Përkrahjen e Agjencisë për Mështetjen e NVM-ve në promovimin e ndërmarrësisë dhe zhvillimit të NVM-ve në Kosovë

3. Ndërsa, AMNVM do të jetë përgjegjëse për:

3.1 Mbështetjen financiare të Ekipit Kombëtar të MGN-së në Kosovë
3.2 Pjesëmarrje në ngjarjet e organizuara nga Ekipi Kombëtar i MGN-së në Kosovë
3.3 Lehtësimin e shpërndarjes së raporteve të MGN-së tek të gjitha grupet e interesit

Neni 3
Pagesat

1. Për realizimin e hulumtimit të "Monitorit Global të Ndërmarrësisë në Kosovë", Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nga buxheti i Agjencisë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme do të mbuloj shpenzimet me vlerë totale prej € 5000, ndërsa buxheti total i projektit është 71,670 euro.

2. Nga kontributi i MTI-së, do të paguhet pjesërisht anëtarësimi vjetor në MGN, i cili në total kap shumën prej €8935 (£7500).

Neni 4

Mbështetja financiare e MTI-së nga buxheti i lartcekur do të bëhet për pjesën e mbulimit të shpenzimeve të specifikuar në Nenin 3, në vlerë totale prej €5000 pas dorëzimit të faturave për shpenzimet gjegjëse.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje është hartuar në tri (3) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga një (1) kopje, derisa një kopje origjinal nevojitet për procedurat e pagesës.

2. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese dhe vlen deri në realizimin e aktivitetit nga Neni 1 i kësaj marrëveshjeje.

Valdrin LLUKA
K.D. Kryeshef i AMNVM-ve

Alajdin Berisha
Kolegji Universum

MARREVESHJE E MIREKUPTIMIT MeM

në mes të:

Projektit "Rritja e punësimit për të rinj (EYE)"
tani e tutje te quajtur "projekti EYE "

dhe

Institucionit të Arsimit të Lartë (IAL) "Kolegji Universum" Prishtinë

PARATHËNIE

Projekti "Rritja e punësimit për të rinj" (EYE), i financuar nga Zyra Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) dhe i zbatuar nga konsorciumi HELVETAS Swiss Intercooperation Kosovë (HSIK) dhe Management Development Associates (MDA) synon që të: unifikojë, përforcojë dhe promovojë skemat dhe procedurat e punës praktike si një instrument të strukturuar, që në mënyrë efektive të kontribuojë në një bashkëpunim më të mirë të Institucioni i Arsimit te Larte (IAL) me ndermarrjet, duke ju mundësuar studentëve tranzicion më të lehtë dhe më të shpejtë në punësim.

Programi i internshipit është një përvojë arsimore që ju ofron studentëve mundësinë për të aplikuar të mësuarit nga klasa dhe punëtoria në vendin e punës, për të zgjeruar shkathtësitë profesionale dhe për t'i pajisur me kredi akademike. Puna praktike mund të ju ndihmojë studentëve për të gjetur punë duke ju dhënë përvojë të dorës së parë në fushën specifike të interesit.

Deri më tani janë zbatuar skema të ndryshme të punës praktike, për këtë arsye për ta arritur këtë qëllim, projekti EYE hyn në partneritet me ofruesit e përzgjedhur të arsimit formal nga sektori i TIKut dhe Agrobiznesit, respektivisht universitetet publike e private, (tani e tutje të referuara si "palë") që bashkarisht të zhvillojnë skema dhe procedura të unifikuara të punës praktike bazuar në të gjeturat nga vlerësimi i skemave të internshipit të zbatuara nga IAL. Në përputhje projekti do të zhvillojë kapacitetet profesionale të personave të caktuar nga IAL dhe instrumentet e nevojshme, të cilat do të siguronin zbatim më të lehtë dhe qëndrueshmëri të skemave dhe procedurave të punës praktike përtej kohëzgjatjes së projektit.

Artikulli 1: Fushëveprimi dhe Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje të themelojë termet dhe kushtet nën të cilat IAL dhe projekti EYE pajtohen të mbështesin zbatimin e aktiviteteve të projektit në përputhje me qëllimin e përgjithshëm të projektit EYE të përshkruar mësipër. Në veçanti, kjo MeM do të përcaktojë përgjegjësitë e të dy palëve për të themeluar bashkëpunim duke e dhënë kontributin e tyre në realizimin e aktiviteteve të ndryshme të projektit.
Detajet specifike të aktiviteteve të përbashkëta, marrëveshjet për ndarjen e shpenzimeve dhe përgjegjësitë e tjera për secilën palë do të përgatiten si anekse të kësaj MeM.

Artikulli 2: Përgjegjësitë e projektit EYE

Projekti EYE do të punojë së bashku me IAL, respektivisht me personat e caktuar nga menaxhmenti i IAL duke ju ofruar asistencë teknike për zhvillim dhe zbatim sa më të mirë të mundshëm të skemave dhe procedurave të internshipit. Stafi apo menaxhmenti i IAL do të jenë të involvuar nga fillimi i intervenimit.

Asistenca e projektit EYE për themelimin e skemave të internshipit në kuadër të IAL do të jetë në:

1. Ofrimin e ekspertizës në formë të konsulencës dhe të formave tjera të asistencës për zhvillimin e instrumenteve për themelimin e skemës;

2. Ofrimin e shembujve të skemave funksionale nga shtetet e tjera;
3. Fasilitimin e diskutimeve me institucione të tjera për të funkcionalizuar skemën;
4. Projekti EYE cakton Znj. Majlinda Bajraktari, eksperten për zhvillim të shkathtësive, përgjegjëse për bashkëpunim dhe komunikim me ShP.

Artikulli 3: Përgjegjësitë e IAL

IAL pajtohet për çështjet në vijim:

1. Të marrë pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e skemave dhe procedurave të përbashkëta të implementueshme si dhe te ofroje informacione lidhur me numrin e studentëve që e kryejne punën praktike përmes skemës së projektit EYE;
2. Të mbështesë zbatimin e skemave të internshipit duke ofruar stafin e saj profesional dhe ekspertizën, dhe resurset e tjera të mundshme sipas nevojës (p.sh. kushtet, pajisjet, etj);
3. Të caktojë një person si kordinator për punë praktike (internship) apo themelojë qendrën për shërbim të studentëve, që do të jetë përgjegjës për zbatim, monitorim dhe vlerësim të punës praktike.
4. Të caktojë një person përgjegjës për bashkëpunim dhe komunikim me projektin EYE.

Artikulli 4. Ndarja e informacioneve dhe konfidencialiteti

Palët për t'a mbështetur këtë marreveshje, do të komunikojnë në mënyrë të rregullt, së paku një herë në muaj, për që të dy çështjet, të natyrës së përgjithshme dhe veçantë. Një komunikim i tillë do të shërbejë për të mbajtur palët e informuara afër për aktivitetet e çdo njërës palë.

Artikulli 5: Baza ligjore dhe kohëzgjatja

1. Kjo marrëveshje do të bëhet efektive posa të nënshkruhet nga të dy palët.
